

HASI
TURISTIK







HASI

Rrethi i Hasit ndodhet në verilindje të Shqipërisë, me qendër qytetin e Krumës. Kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Është një zonë kodrinore-malore, e njohur për traditat kulturore, historinë e pasur dhe pozitën gjeografike që e lidh me rajonet përreth







PASHTRIKU



Pashtriku është zona malore më e rëndësishme e Hasit, e vendosur në kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës, me një lartësi prej 1,986 metrash mbi nivelin e detit.
Me reliev të ashpër, bukuri natyrore dhe pamje mbresëlënëse, ai tërheq alpinistë dhe dashamirës të natyrës. Ka edhe rëndësi historike e kulturore, pasi është përdorur nga luftëtarët shqiptarë në periudha të ndryshme.






FSHATI CAHAN



Unik për peizazhin, natyrën, klimën dhe mikëpritjen e banorëve: vendi i duhur për të braktisur përditshmërinë e zhurmshme të jetës urbane.



Fshati Cahan është shpallur nga qeveria shqiptare si një nga 100 fshatrat turistikë, duke u vlerësuar për bukurinë natyrore, traditat e pasura dhe potencialin e tij për zhvillimin e turizmit rural.



PISHA GJINAJ



Pisha e Gjinajt ndodhet rreth 700 metra mbi nivelin e detit dhe dallohet për veçantinë e saj, pasi është e vetmja e këtij lloji në atë zonë. Është një pemë monumentale e vendosur në një mjedis malor

GURRA DOMAJ

Burim uji dhe monument natyror me rëndësi lokale, i njohur për freskinë dhe bukurinë e ambientit përreth.





SHPELLA PËLLUMBAVE





Shpella e Pëllumbave ose e (Shpella e 3 Dritareve) ndodhet 1300 metra mbi nivelin e detit, në vargmalin e Pashtrikut, mes fshatrave Vlahen, Dobrune, Nikoliq dhe Greçinë. E rrethuar nga pyje të dendura dhe një bimësi e larmishme, zona është shumë tërheqëse në pranverë dhe përdoret shpesh për ekskursione. Shpella mbetet e paeksploruar plotësisht, por paraqet interes të veçantë për natyrën dhe misterin që ofron.

AHISHTJA LIKENIT KUQ








Ahishta e Liqenit të Kuq ka një sipërfaqe prej 12 hektarësh dhe ndodhet pranë fshatit Liqeni i Kuq, në një lartësi prej 300 – 370 metrash mbi nivelin e detit, buzë liqenit të Fierzës. Ky është një pyll ahu (Fagus sylvatica), i cili rritet shumë më poshtë se sa lartësia tipike ku zakonisht gjendet ky lloj druri në Shqipëri (mbi 1000 metra mbi nivelin e detit). Kjo e bën zonën të veçantë dhe tepër interesante nga pikëpamja ekologjike.

Drurët e ahut arrijnë lartësi prej 25 – 28 metrash, me diametër trungjesh nga 35 deri në 57 cm dhe moshë që varion nga 80 deri në 150 vjet.

KULLA KURPALIT








Kulla e Kurpalëve në Letaj, Has, është një monument kulture, ndërtuar rreth 150 vite më parë nga bijtë e Kurpalit. Ajo ka qëndruar ndaj kohërave të vështira dhe sot është një muze i hapur që pasqyron historinë, traditën dhe krenarinë shqiptare. Vizitorët mund të shohin nga afër arkitekturën e saj dhe të njohin jetën tradicionale dhe ngjarjet historike që lidhen me këtë kullë, një simbol i gjallë i identitetit të Hasit.






Burimi i Krumës është një monument natyror i vendosur rreth 480 metra mbi nivelin e detit, pranë qytetit të Krumës. Ky burim karstik ka një prurje mbresëlënëse prej 600 litrash në sekondë. I njohur ndryshe edhe si Vrella, ai përbën një burim shumë të rëndësishëm për qytetin tonë, si për nga vlera natyrore, ashtu edhe për rolin e tij jetik në furnizimin me ujë.



Xhamia e Tregtanit është një nga xhamitë më të vjetra në qarkun tonë, me një histori rreth 300-vjeçare. Ajo përbën një trashëgimi të veçantë arkitektonike për komunitetin tonë, duke reflektuar traditat dhe kulturën e kohës që ajo është ndërtuar.

HASI ËSHTË NJË TREVË ME HISTORI TË PASUR, TRADITA TË LASHTA DHE NATYRË TË MREKULLUESHME. ME NJË KULTURË TË VEÇANTË QË RUHET ME KRENARI NGA BANORËT E TIJ, DHE ME BUKURITË NATYRORE.
HASI MBETET NJË PERLË E VERIUT TË SHQIPËRISË. ËSHTË NJË VEND KU MIKPRITJA, HISTORIA DHE NATYRA BASHKËJETOJNË NË HARMONI.











CONTACT

Adresa:
Sheshi “Deshmoret e Hasit”,
Pallati i Kultures “Pjeter
Bogdani”, Qyteti Krumë

Email:info@bashkiahas.gov.al

Kryetari i Bashkisë Has Z.Miftar Dauti

Email: miftar.dauti@bashkiahas.gov.al

Zv/kryetari Z.Zenel Sheta

Email: zenel.sheta@bashkiahas.gov.al

Zv.kryetarja Zj.Shyrete Koka

Emaili:shyrete.koka@bashkiahas.gov.al

Kordinatore për informim: Emirela Patarria

Email: emirelapatarria@bashkiahas.gov.al

Zyra Zhvillimit Ekonomik
Vendor dhe Turizmit

Punoj : Selami Kastrati



